



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,**  
**trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023**

**Nr. Dok. 202300609/1**

**Lënda:** *Rekomandohet mbyllja e IEVP Ali Demi dhe sistemimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve në një institucion alternativ të vuajtjes së dënimit.*

**Drejtuar :** **Ulsi MANJA**  
**Ministër i Drejtësisë**

**Z. Admir ABRIJA**  
**Drejtore i Përgjithshëm i Burgjeve**

**Znj. Lindjana LAÇI**  
**Drejtoreshë e IEVP "Ali Demi"**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në I.E.V.P. 325 "Ali Demi" Tiranë në datat 27.06.2023 dhe 2.08.2023. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, z. Hazbi Selita, znj. Lindita Dedëgjoni dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/ komisionerë pranë këtij Mekanizmi, më tej më datë 02.08.2023 Avokatja e Popullit kreu gjithashtu një vizitë tjetër në këtë IEVP për të bërë një vlerësim përfundimtar të disa prej problematikave të ngritura nga grupi i inspektues të cilat janë shume te rëndesishme per mireqenien e te paraburgosurve e te denuarave, por përbëjnë edhe rekomandime të përsërituara për disa vite rrjesht.

Si shpjeguar edhe më sipër, objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) 325 Tiranë, cilësia

e trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve brenda tij, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit u takua fillimisht me drejtuesen e institucionit znj. Elona Demollari, e cila shprehu angazhim në trajtimin e çështjeve dhe gjetjen e zgjidhjeve por problemet infrastrukturore ishin shumë të dukshme. Grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të kryer vizita në të gjithë ambientet që duhet të monitoronin, si dhe për zhvillimin e takimeve dhe intervistave konfidenciale me personat e dënuar/ paraburgosur.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit ligjor t'ju parashtrrojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

### **Shënime të përgjithshme**

Këto vizita monitoruese të Avokatit të Popullit në I.E.V.P 325 ishin të paparalajmëruara dhe u zhvilluan pa mbikëqyrjen e stafit duke zhvilluar biseda konfidenciale me të dënuarat dhe të paraburgosurat.

Drejtuesja e institucionit, pasi u njoh me planin e inspektimit, informoi lidhur me kushtet e trajtimit dhe situatën e respektimit të të drejtave të dënuarave/paraburgosurve në këtë institucion. Në vijim, grupi inspektues kërkoi nga shefat e sektorëve dhe të shërbimeve, vënien në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit lidhur me organikën, programet vjetore të punës dhe aktiviteteteve të sektorit juridik, sektorit të kujdesit dhe shërbimit social, të shërbimit shëndetësor, sektorit të policisë, etj.

Grupi i inspektimit u informua se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018, "*Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*", Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale 325 Tiranë është kategorizuar si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion për të dënuarat e sigurisë së zakonshme dhe një seksion për të paraburgosurat.

Ky institucion ka një **kapacitet maksimal prej 100** i përcaktuar së fundmi me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me Nr.735 Prot, datë 04.05.2023. Avokati i Popullit nuk morri informacion që ky kapacitet të jetë përcaktuar sipas parashikimeve të ligjit nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të Paraburgosurve*", e përcaktuar, në VKM Nr.209, datë 06.04.2022 "*Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve*" që përcakton kapacitetet e nevojshme për çdo të dënuar apo paraburgosur.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ndodheshin 29 të burgosura dhe 48 të paraburgosura pra në total 77 persona.

Në këtë institucion kishte edhe 3 (tre) shtetase të huaja, përkatësisht 2 (dy) me shtetësi Rumune dhe 1 (një) me shtetësi Iraniane.

Të dhënat e popullimit në këtë institucion për gjashtë mujorin e fundit janë sa më poshtë:

*Muaji Janar janë të paraburgosura 39, të dënuara 26 në total 65*  
*Muaji Shkurt janë të paraburgosura 46, të dënuara 27 në total 73*  
*Muaji Mars janë të paraburgosura 48, të dënuara 27 në total 75*  
*Muaji Prill janë të paraburgosura 47, të dënuara 29 në total 76*  
*Muaji Maj janë të paraburgosura 43, të dënuara 29 në total 72*  
*Muaji Qershor të paraburgosura 48 , të dënuara 29 në total 77*  
*Muaji Korrik të paraburgosura 44 , të dënuara 31 në total 75*

Nga sa më sipër rezulton se nuk ka popullim jashtë kapaciteteve të miratuara. **Në regjimin e paraburgimit** nga data 01.01.2023 deri në datën 27.06.2023 ka patur 30 (tridhjetë) hyrje të reja në institucion dhe 12 (dymbëdhjetë) lirime. **Në regjimin e burgimit** nga data 01.01.2023 deri në datën 27.06.2023 ka patur 9 (nëntë) hyrje në institucion dhe 5(pesë) lirime.

I.E.V.P “Ali Demi” sipas organikës së miratuar me Urdhër Nr.174 datë 19.10.2022 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, përbëhet prej: sektori civil 35 punonjës, sektori i policisë 73 punonjës në total 108 punonjës. Mungesat në staf ishin: 1 infermier, 1 mirëmbajtës dhe 3 punonjëse me leje lindje, dy prej të cilave janë zëvendësuar ndërsa farmacisti është në mungesë. Lidhur me këto mungesa, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka komanduar në I.E.V.P. 325 “Ali Demi”, 1 punonjës kujdestar dhe 1 punonjës social.

Punonjësit civil ishin të ndarë në sektorë për ushtrimin e detyrave si:

- Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve 15 punonjës
- Sektori Ligjor 4 punonjës
- Sektori i çështjeve shoqërore 4 punonjës
- Sektori i financës me staf 3 punonjës
- Sektori i shërbimit të kujdesit shëndetësor 8 punonjës
- Sektori i policisë me 73 punonjës.

Sipas të dhënave dhe informacioneve që u grumbulluan gjatë vizitës inspektuese nëpërmjet intervistave konfidenciale me gratë e privuara nga liria dhe bisedave me stafin e institucionit, si dhe mënyrën e trajtimit dhe adresimit të problematikave pranë organeve eprore, për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm<sup>1</sup>:

-Ishin marrë masat për kryerjen e punës proaktive dhe dhënien e shërbimeve shëndetësore me cilësi nga sektori psiko-social dhe ai shëndetësor në këtë institucion.

***Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të mëparshme të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar:***

---

<sup>1</sup> Rekomandim nr.K4/I60-2Prot, Tiranë 25.02.2022.

- ✓ Nuk ishin marrë masat për rikonstrukcionin e plotë të godinave të këtij institucioni, në të cilën të burgosurat qëndrojnë në kushtet e një trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Si i vetmi institucion i ekzekutimit të vendimeve penale për gratë në Shqipëri, institucionet përgjegjëse duhet të kenë si qëllim prioritar sigurimin e kushteve minimale për një jetesë dinjitoze dhe një trajtim sa më të denjë.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për riparimin e të gjithë ambienteve të regjimit të brendshëm si dhe riparimin e tualeteve dhe dusheve.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për sigurimin e ngrohjes për periudhën e dimrit dhe instalimin në institucion të një sistemi qendror ngrohës, dhe në çdo rast moskufizimin e kohës së përdorimit të ngrohjes.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për krijimin e mundësisë për mësimin e gjuhës shqipe si një nga aktivitetet për të burgosurat e huaja që vuajnë dënimin në këtë institucion, (shtetësia e huaj me kombësi Iraniane adresoi grupit të inspektimit këtë ankesë).
- ✓ Nuk ishin marrë masa për rritjen dhe garantimin e cilësisë dhe larmisë së ushqimit.
- ✓ Nuk ishin marrë masat për furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale, sipas të dënuarave/paraburgosurave sasia e detergjenteve që merrnin nga institucioni ishte e pamjaftueshme duke marrë në konsideratë dhe faktin se tualetet në ambientet e banimit janë tepër të konsumuara dhe me mungesë të theksuar higjiene.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) 325 “Ali Demi” ka kushte të papërshtatshme për banim, u evidentua mungesa e investimeve në ambientet e përbashkëta të jetesës së të dënuarave/ paraburgosurave, ambientet kishin nevojë emergjente për riparimin e tualeteve, tubacioneve, pajisjeve hidrosanitare, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.

Përgjatë bisedës me titullaren e institucionit u informuam se është ngritur ky shqetësim si nevojë emergjente dhe janë adresuar të gjithë problematikat dhe gjetjen e zgjidhjeve sa më të shpejta, por ende nuk ka patur asnjë reagim nga institucionet përgjegjëse. Kërkesat për investime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, konkretisht për vitin 2024 janë përcjellë sipas shkresës Nr.1510 datë, 14.04.2023 "Kërkesë për investime për projekt buxhetin e vitit 2024-2026, janë kërkesa që realizohen me fonde e procedura nga kjo instancë, pra janë jashtë kompetencave ligjore të institucionit. Në kërkesat drejtuar DPB është pasqyruar gjendja e infrastrukturës së institucionit (tejet të amortizuar, ndërtime të viteve 1970, tërësisht me mbulesë llamarinë dhe pjesërisht me internet), kërkesë për rikonstrukcion të përgjithshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se edhe vendodhja e institucionit në një zonë të banuar, me shumë pallate pranë është tërësisht e papranueshme për të krijuar kushtet e nevojshme edhe nëse do të bëhej rikonstrukcioni. E vetmja zgjidhje do të ishte ndërtimi nga e para i një strukture të posaçme që të plotësojë të tëra nevojat.

### ***Trajtimi i të dënuarave/paraburgosurave***

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjedhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, komisionin për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësinë e ushqimit, furnizimin sipas normativës me detergjente dhe mjete të higjienës personale.

Nga intervistat e zhvilluara me një grup të dënuarash dhe të paraburgosura, grupi i inspektimit **evidentoi raste dhe pretendime për presion psikologjik mungesë komunikimi nga ana e punonjësve të policisë** por nuk konstatuam raste keqtrajtme dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni.

Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurat, ishin jo të mira dhe aspak korrekte, kërcënuese dhe intimiduese një fakt ky i konfirmuar dhe nga drejtoresha e burgut, e cila e kishte trajtuar dhe ngritur si problem por përgjatë inspektimit konstatuam se kjo situatë vazhdonte të ishte prezentë. Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Kreu 2 Parimet Themelore, Neni 5. Respektimi i të drejtave të njeriut pika 4.citohet se: Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose *psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi*. Avokati i Popullit kërkon me forcë reagimin e menjëhershëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe nga Stafi i I.E.V.P. 325 “Ali Demi” të evidentojë sa më shpejt problematikën dhe trajtimin e ankesave të të dënuarave dhe paraburgosurave të cilat ishin në presion psikologjik të vazhdueshëm të friksuara nga stafi policor, dhe këtë fakt e konfirmuan pothuajse të gjitha në bisedat konfidenciale me ekipin inspektues të Avokatit të Popullit. Në datën 19.07.2023 në këtë institucion është ndërruar drejtuesja dhe kjo tregon marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për adresimin e këtij shqetësimi.

Mekanizmi Kombëtar përgjatë inspektimit u takua dhe me disa të dënuara të cilat më herët kanë bërë ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit të cilat janë trajtuar dhe trajtohen me përparësi.

Ankesat e parashtruara përgjatë inspektimit ishin sa më poshtë:

- Mungesa e tendave në ambientet e ajrimit ishte problem i vazhdueshëm për to, si për periudhën e dimrit po ashtu edhe ato të verës,
- tharja e rrobave përbënte problem, pasi në dimër ishte shumë e vështirë të thaheshin duke qenë se ambienti nuk kishte strehë mbrojtëse;
- ankesa mbi lagështirën e theksuar, tavanet që pikonin ujë, çka u verifikua edhe përgjatë inspektimit;
- mungesa e ujit në dhomat e fundit të paraburgimit të cilat për shkak të infrastrukturës dhe pjerrësisë uji në tubacione nuk shkonte deri tek dhomat e tyre.

- një numër të konsiderueshëm ankesash ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion, sipas tyre ky institucion ishte kthyer në të pabanueshëm dhe tashmë përbënte rrezik për shëndetin e tyre;
- ankesa të shumta vinin dhe për prezencën dhe ndërveprimin e juristit të institucionit me të paraburgosurat/dënuarat;
- pothuajse të gjitha të dënuarat/paraburgosurat u ngrit shqetësimi mbi shumëllojshmërinë e ushqimit;
- në lidhje me furnizimin sipas normativës sipas tyre shumë të vogël në sasi me detergjente dhe mjete të higjenës personale, duke marrë shkas dhe nga gjendja infrastrukturore e dhomave të banimit.

Gjatë vizitës së Avokatit të Popullit më datë 02.08.2023, me përjashtim të një rasti nuk pati asnjë pretendim për presion në të kundërt situata dukej shumë pozitive dhe me frymë të mirë bashkëpunimi. Gjithsesi kushtet infrastrukturore tërësisht të papranueshme nuk lejojnë që të burgosurat apo paraburgosurat të zhvillojnë të tëra aktivitetet e duhura të rehabilitimit.

Qëndrimet në këto ankesa do të trajtohen më poshtë.

### **Masat mbrojtëse.**

Në përputhje me standardet e përgjithshme të drejtave të njeriut, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikatat e punës sipas sektorëve, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e të dënuarave dhe të paraburgosurave.

Ekspertët fillimisht morën informacion në lidhje me procedurat e ndjekura për pritjen e të burgosurve në institucion, si dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes. Nga intervista e zhvilluar me drejtuesen e institucionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit grupi i inspektimit konstatoi se, procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte dhe regjistrat e dosjet personale të të burgosurve ishin plotësuar sipas rubrikave.

Vëmendje e veçantë ju kushtua mënyrës si funksiononte sistemi i kërkesë/ankesave. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve ishin të regjistruara në regjistrin përkatës dhe ishin të protokolluara. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit. Nga verifikimi i regjistrat të kërkesave të dënuarave për periudhën janar –Dhjetor 2022 në I.E.V.P. 325 “Ali Demi” rezultoi se numri i kërkesë/ankesave për periudhën Janar-Dhjetor ka qenë 667 ankesa dhe kërkesa.

Të burgosurat pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin më pas te punonjësit e sektorit psiko-social. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor.

Sipas shënimeve në regjistër, objekti i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital, ose kërkesa për blerje të ndryshme.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në I.E.V.P. 325 “Ali Demi” ishte e instaluar një DVR dhe pamjet filmike ruheshin për 30 ditë. Mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarave, ashtu dhe nga vetë punonjëset e policisë së burgjeve. Dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarave dhe të paraburgosurave. Nga inspektimi i ambienteve u konstatua se **ambienti i mensës ku konsumohej ushqimi** nuk ishte i monitoruar nga kamerat çka ishte kthyer në shqetësim edhe për të dënuarat pasi sipas tyre ishte e domosdoshme për transparencë në lidhje me çdo debat apo konflikt të mundshëm në këtë ambient.

Aparatet e telefonave me kartë, ishin të instaluar në oborret e secilit prej seksioneve në regjimin e brendshëm. Aparatet e telefonave ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të burgosurat, deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 16 telefonata në muaj. Nga verifikimi i aparateve telefonik me kartë u konstatua se, të dënuarat mund të lidheshin me numrin e telefonit të Avokatit të Popullit (pa pagesë). Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve: I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrave të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur.

Ndërkohë që në këtë institucion ishte vendosur në dhomën e takimeve me familjarët edhe një post ku të dënuarat mund të kryenin 1 (një) takime online me familjet e tyre nëpërmjet platformës “Skype”.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale 325 Tiranë, sipas organikës ishin të punësuar 7(shtatë) të dënuara/paraburgosura, në pozicione pune si sanitare, shpërndarëse ushqimi, mirëmbajtëse. Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve parashikohet në nenet 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 44 të ligjit të cituar më sipër parashikohet se: 1. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. I burgosuri ka të drejtë të disponojë lirshëm dyzet për qind të të ardhurave të fituara nga puna.”

Nga takimi i grupit inspektues më të dënuarat dhe paraburgosurat që punonin brenda institucionit këto të fundit nuk kishin pretendime për kushtet e punës si dhe të gjitha kishin lidhur kontratat e punësimit.

### **Kushtet materiale**

Grupi i monitorimit, kishte në fokus të vizitës inspektuese plotësimin e kushteve materiale, si një prej elementeve shumë të rëndësishëm të respektimit të standardeve të jetesës por që

nuk ka pasur që në momentin e lëvizjes destinacion funksional për I.E.V.P, për të burgosurit. I.E.V.P 325 është një institucion i vjetër i krijuar që prej vitit 1976. Infrastruktura e institucionit përbëhet nga godina akomodimi 1 (një) katëshe dhe ambiente ajrimi të jashtme, pa streha mbrojtëse dhe të shtruara me beton por pa sistemime të përshtatshme. Ndërtesa e kësaj I.E.V.P.-je, përveç se është e amortizuar, nuk i plotëson kushtet e përshtatshme higjienike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të përmbajtura në legjislacionin shqiptar por edhe ato të përcaktuar nga CPT, gjendja teknike e godinave të banimit vijon të jetë tejte e amortizuar dhe lagështira të jetë prezente në të gjitha ambientet e kësaj I.E.V.P.-je.

**Observimi/ veçimi** është sektor i rëndësishëm për mbajtjen, kujdesin e veçantë të paraburgosurave të cilat akomodohen rishtazi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) 325. Në ambientet e veçimit kishte 3 dhoma për mbajtjen e të paraburgosurave me masë disiplinore. Dhomat u gjendën të lyera me gëlqere, të pastra dhe të pajisura vetëm me një krevat hekuri me dyshek, jastëk dhe batanije. Dhoma mbyllej me derë hekuri me shul me një dritare të vogël të bllokuar me zgarë hekuri. Ndriçimi natyral mundësonte leximin, ndërsa ndriçimi artificial nuk sigurohej i plotë pasi llamba ishte vendosur për arsye sigurie jashtë dhomës. Tualeti i veçimit ishte me sipërfaqe të vogël, kishte dush dhe WC. Bojleri dhe lavamani ishin vendosur në korridorin e dhomave, ku edhe kryhej ajrimi.

Mjedisi në të dy regjimet vijon të jetë tejte i amortizuar dhe me lagështirë. Për sa i përket kushteve materiale dhe lagështirës, vihej re një përkeqësim në të dy sektorët si në paraburgim ashtu edhe në sektorin e burgut.

Ambientet e përbashkëta të vizituara gjatë inspektimit në sektorin e të dënuarve janë: çerdhja, dhomat ku mbahen të burgosurat me masë disiplinore “përrjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta” (veçimi), seksioni i kujdesit të veçantë (SKV), biblioteka, mensa, kuzhina, tualeti, parukeria, rrobaqepësia.

Në këtë I.E.V.P., dhomat e banimit janë sipas sistemit të hapur, duke u krijuar mundësi të dënuarave/ paraburgosurave të kenë akses me orare të zgjatura ajrimi në oborret e sektorëve përkatës. Mesatarisht në çdo dhomë kishte 4-6 persona. Dhomat e banimit ishin të përmasave të ndryshme por kushtet brenda tyre ishin tejte të papërshtatshme për të siguruar trajtim njerëzor dhe jo denigrues. Sipas të burgosurave përgjatë ditëve me shi në dhoma vendosin kova për të pritur ujin që rrjedh nga tavanet e dhomave, kurse gjatë ditëve me temperatura të larta ambientet e dhomave ishin shumë të nxehta. Evidente ishte mungesa e dollapëve për mbajtjen e ushqimeve dhe rrobave. Asnjë prej dhomave nuk kishte brenda tualete, ato ishin të përbashkëta dhe në kushte të papërshtatshme. Sipërfaqja dhe kapaciteti i dhomave ishte i përcaktuar sipas numrit të shtretërve dhe jo sipërfaqes së tyre.

Në institucion **mungonte sistemi qendror i ngrohjes**. Për periudhën e dimrit ngrohja sigurohej vetëm nëpërmjet rezistencave, të cilat lejoheshin të përdoreheshin një kohë të kufizuar, por sipas të burgosurave në kushtet e një lagështie të theksuar ishte e pamundur që të përballohej i ftohti.

**Regjimi i të dënuarave** kishte një godinë, e cila paraqitej në kushte të mira e pajisur me të gjitha orenditë e nevojshme dhe shërbente si çerdhe për fëmijët deri në moshën 3 vjeç.



Çerdhja ndiqet 24 orë nga mjeku, infermieri dhe kujdestari. Në godinën e çerdhes ka dhomë qëndrimi për stafin, tre dhoma qëndrimi për të burgosurat me fëmijë nën moshën tre vjeç dhe një kuzhinë. Një dhomë shërben për prindërimin në distancë për të burgosurat me fëmijë mbi 3 vjeç. Dhomat janë të pajisura me orenditë e nevojshme dhe me lodra për fëmijë. Godina e çerdhes ndodhet e veçuar nga dhomat e banimit të të dënuarve dhe në hyrje të saj, janë mbjellë lule. Çerdhja kishte ambiente të mirë organizuara të ndara në katër dhoma për fëmijë:

- një dhomë për nëna me fëmijë;
- një dhomë vetëm për fëmijë;
- një dhomë lojërash;
- një dhomë për edukatore.
- 

Të gjitha dhomat e godinës së çerdhes ishin të pajisura sipas standardeve me orenditë e nevojshme dhe me materiale shëndetësore e informuese për nënat me fëmijë. Çerdhja kishte një personel prej 5 vetash, të ndarë në 2 edukatore, 2 infermiere dhe një kujdestare. Në këto ambiente nuk kishte asnjë person të akomoduar.

**Ambientet e veçimit** përbëheshin nga 2 dhoma për mbajtjen e të dënuarve me masë disiplinore. Dhomat u gjendën të pastra dhe të lyera. Ato ishin të pajisura vetëm me shtrat hekuri. Ndriçimi natyral nuk ishte i mjaftueshëm, pasi përhapej në dhomë vetëm nëpërmjet një dritareje të vogël me rrjetë teli të derës. Ndriçimi artificial përhapej i zbehtë pasi për arsye sigurie llamba ishte vendosur në një frëngji në lartësi të murit të mbyllur me zgarë hekuri dhe rrjetë teli. Tuelalet ndodhej jashtë dhomave dhe ishte pajisur me një WC model turk dhe dush, bojleri ishte vendosur brenda tualetit. Ajrimi kryhej në korridorin e dhomave.

Shtrojat (jastëkë e batanije) në shumicën e rasteve siguroheshin nga familjarët, pajisjet e hotelerisë, të higjienës personale dhe të përbashkët siguroheshin edhe nga institucioni.

Kuzhina ishte e pastër dhe e rregullt, me kampionë ushqimorë të ruajtur në kushte frigoriferike por ajo çka konstatoam ishte se ato **nuk ishin të etiketuara sipas vakteve ushqimore**. Menyja javore ishte e afishuar, mensa ishte e pajisur me orendi si tavolina, karrige, lavamanë dhe rafte, ku secila e dënuar mbante të mbyllura me çelës ushqimet, që i sjell familja.

Në institucion, secili sektor kishte nga një bibliotekë, të cilat ishin të mirëpajisura me libra, orendi si tavolina e karrige, një TV plazma. Këto 2 ambiente shfrytëzoheshin nga sektori i edukimit për aktivitete të ndryshme që zhvilloheshin në këtë institucion. Biblioteka ishte e lyer dhe e pastër. Dritaret mundësonin ndriçim natyral të mjaftueshëm për të lexuar dhe punuar. Në bibliotekë, përveç orendive dhe rafteve të mbushura më libra kishte edhe një kompjuter funksional, ndërsa në televizor shfaqeshin filma të ndryshëm. Në mur prezantoheshin piktura të të burgosurave si dhe ishte afishuar dukshëm numri i kontaktit të Institucionit të Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe D.P. Burgjeve.

Seksioni i kujdesit të veçantë ndodhej midis çerdhes, dhomës së veçimit dhe dhomave të banimit të të dënuarve. Ky sektor kishte dy dhoma dhe oborr.

Të dënuarat/ paraburgosurat mund të praktikonin rritet fetare në dy dhomat që ndodheshin në ambientin e paraburgimit, përkatësisht njëra dhomë për fenë myslimane dhe tjetra për fenë katolike/ ortodokse. Të dyja dhomat ishin të plotësuara me bazë materiale dhe literaturë të nevojshme për praktikuesit e feve përkatëse.

Seksioni i paraburgimit ka një dhomë veçimi me dritë natyrale dhe dritë artificiale, dhe e pajisur me 2 shtretër me sfungjer. Kubatura e dhomës ishte e vogël dhe e pamjaftueshme për kapacitetin me 4-6 të dënuara. Nga vëzhgimi i dhomave u konstatua se dhomat ku qëndronin 6 të paraburgosura ishin të vogla dhe nuk siguronin hapësirën e nevojshme të parashikuara nga rregulloret. Gjithashtu u verifikua se kishte dhoma në të cilat ishin akomoduar 3-4 të dënuara.

Theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6 m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4 m<sup>2</sup> për dhoma me më shumë persona.<sup>2</sup> Në këtë përcaktim nuk merret parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, e cila duhet të jetë jo më pak se 2 m në gjerësi dhe jo më pak se 2.5 m në lartësi nga dyshemeja me tavanin e dhomës. Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve, u vu re se baza materiale nuk ishte plotësuar si duhej, kishte mungesa në pajisje dhe orendi të amortizuara.

## **Regjimi dhe aktivitetet**

Spektori i çështjeve shoqërore në organikën e tij përbëhej nga: 1 përgjegjës sektori, një psikolog dhe një specialist punonjës social. Dokumentacioni i stafit psiko-social ishte i rregullt dhe i plotësuar me raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori. Stafi dispononte dosjet psiko-sociale dhe programet individuale të trajtimit për të dënuarat me probleme të shëndetit mendor, për grup moshën 18-21 vjeç dhe abuzuesit me substancat.

Sa i takon mbështetjes psiko-sociale që merrnin të dënuarat/ paraburgosurat, gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social, u konstatua se aktivitetet që ofroheshin ishin të pakta dhe përbëheshin kryesisht nga diskutimet në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit apo në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin kur ajo ishte e lirë. Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato ishin të plotësuara relativisht mirë, me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet ishin përfshirë programet individuale të trajtimit dhe vlerësimet periodike të cilat ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarat, vlerësimet tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

---

<sup>2</sup> Albania: Visit 1997 [par.127] Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) pranë Këshillit të Europës me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoritetet Shqiptare:  
“Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo më pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6 m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

Në institucion, shpërndarë nëpër zyra, gjendej dhe një numër i konsierueshëm librash që viheshin në dispozicion të të paraburgosurave /dënuarve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurat dhe të dënuarat e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave. Në institucion vuanin dënimin dhe 3 shtetase të huaja të cilat kishin vështirësi në komunikim me stafin e institucionit si dhe me marrjen e informacionit ose kryerjes së aktiviteteve të ndryshme si leximi etj. Për këtë arsye është e domosdoshme që kjo problematikë të marrë zgjidhje sa më parë duke ju krijuar mundësinë për mësimin e gjuhës shqipe.

U konstatua se ajrimi ditor zgjaste mjaftueshëm, të dënuarat/ paraburgosurat mund të qëndronin për një kohë të gjatë në ambientin e ajrimit. Vlen për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri të të dënuarave në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”. Shumë prej të intervistuarave në dhoma kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive.

Përgjatë inspektimit të burgosurat i adresuan grupit të inspektimit kërkesën për amnisti të cilën e kanë depozituar pranë Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, sipas tyre ndonëse kanë kaluar muaj ende nuk kanë një përgjigje nga institucionet lidhur me këtë çështje.

### **Shërbimi Shëndetësor**

Gjatë vizitës në I.E.V.P 325, nga intervistat me të dënuarat dhe paraburgosurat, nuk u konstatuan problematika të lidhura me shërbimin shëndetësor. Skema e furnizimit me ilaçe funksiononte normalisht për të sëmurët kronikë, shërbimi stomatologjik ishte furnizuar me bazën materiale.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P 325 përbëhej nga 7 punonjës prej të cilëve 1 (një) mjek, 1 (një) farmacist, 1 (një) stomatolog dhe 4 (katër) infermierë.

Mjekja aktuale punonte me kohë të plotë megjithëse për nevoja të institucionit ishte e pamjaftueshme. Një nga qëndrimet e KPT<sup>3</sup> konsiston se “derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në mënyrë, që të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”. Gjatë inspektimit dhe intervistimeve të të dënuarave/ paraburgosurave, u konstatua se mendimi për shërbimin shëndetësor në përgjithësi ishte pozitiv dhe vlerësohej gatishmëria e stafit si për vizitat mjekësore në institucion, ashtu dhe për konsultat me

---

<sup>3</sup> KPT raporti për vizitën monitoruese të Shqipërisë në vitin 2018, <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-albanian-response-to-the-report-on-the-2018-visit>.

specialistë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve dhe në QSUT “Nënë Tereza”, Tiranë.

Në I.E.V.P 325 ndodheshin 78 (të dënuara/paraburgosura) nga të cilat 38 janë të sëmura kronike të ndara në 24/paraburgosura dhe 14 të dënuara, ndërsa përdorues droge gra të cilat merrnin trajtim me metadon ishin 2 të paraburgosura.

Të burgosura me probleme të shëndetit mendor në institucion ishin 14 gra nga të cilat 6 të dënuara dhe 8 të paraburgosura, sipas këqyrjes së kartelave mjekësore trajtimi i tyre vazhdonte në mënyrë periodike me konsulta psikiatrike 1 herë në muaj, të cilat nuk ishin të mjaftueshme ndërkohë që vijonin të merrnin mjekimet përkatëse të rekomanduara nga specialistja. Farmacia ishte e kompletuar, me të gjitha medikamentet e emergjencës po ashtu edhe me medikamentet për gratë të cilat kishin sëmundje kronike dhe kishin terapinë përkatëse.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit të mjekes, formateve të kontrollit mjekësor, regjistrin të vizitave, atij themeltar për kartelat dhe atij të rasteve të evidentimit për dhunë fizike u konstatua rregullsi në mbajtjen e tyre. Kartelat edhe regjistrat që administroheshin nga infermierët rezultuan të plotësuar mirë.

Të gjithë të dënuarat/ paraburgosurat ishin të pajisura me librezë shëndetësore dhe skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte dhe nuk kishte vonesa në zbatimin e saj.

Nga kontrolli i dokumentacionit të stafit mjekësor, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Ne perfundim, pas marrjes së rezultateve të vizites inspektuese nga grupi i inspektimit dhe pas diskutimit të tyre me stafin e institucionit, Avokatja e Popullit bëri një vizitë të dytë në këtë IEVP. Kjo vizitë erdhi edhe pas disa ndryshimeve të bëra në stafet drejtuese të IEVP 325 në fund të korrikut. Avokati i Popullit vlerëson se mundësia e stafit të ri për të bërë ndryshime thelbësore në këtë IEVP është e vogël nëse nuk ndryshohen thelbësisht kushtet infrastrukturore në të cilat ndodhet ky institucion. Në të vështiresisht mund të realizohet mandati i sistemit penitenciar për reintegrimin e personave në jetën shoqërore. Avokati i popullit, pavarësisht kohës së shkurtër në të cilën kanë qenë në detyrë stafi i ri vlerëson se qasja ishte me pozitive dhe se kishte bashkëpunim me të mirë e frymë me të mirë bashkëpunimi edhe falë akviteteteve të shpeshta të koheve të fundit.

Në çdo rast, në vlerësojmë se qëndrimi i tyre në këtë institucion në kushte infrastrukturore krejtësisht të papërshtatshme për jetesën e tyre përben trajtim jo dinjitoz e denigruar dhe për këtë arsye Avokati i Popullit kërkon mbylljen sa më parë të kësaj IEVP dhe dergimin e të dënuarve në një institucion alternativ. Avokati i Popullit, duke e njohur edhe gjendjen e infrastruktures së sistemit penitenciar, sugjeron se struktura me të pershtatshme që në një kohë të shpejtë mund të plotësojë nevojat për akomodim të të paraburgosurave dhe të dënuarave gra në vend është IEVP e ndërtuar rishtas në qytetin e Pogradecit. Kjo IEVP ka kushtet me të mira infrastrukturore dhe është e pershtatshme për të siguruar trajtim dinjitoz të tyre në periudhë afatshkurter. Avokati i Popullit vlerëson edhe një herë punën e vijueshme të bërë në sistemin penitenciar për ta reformuar dhe shndërruar atë në një sistem modern e

qe te garantoje mireqenien e personave te paraburgosur ose te denuar, por nga ana tjetere vlerson se trajtimi i te tere numrit te grave qe vuajne masat ndaluese ne kete sistem mbetet jodinjitoz e ploteson kushtet e nenin 3 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut. Per kete arsye, i kerkon si Ministrise se Drejtesise ashtu edhe Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve te vleresojme me kujdes e seriozitet kete rekomandim te Avokatit te Popullit edhe te adresojne me prioritet kushtet ne te cilat ndodhen grate edhe si nje kategori vulnerabel. Nga bisedat e bera me to gjate vizitave inspektuese ishte e qarte se behet fjale ne masen me te madhe per persona qe kane histori shume te vuajtuara dhe i perkasin me se shumti, asaj kategorie qe eshte me vulnerabel brenda komunitetit te grave ne shoqerine tone. Per sa me siper do te vleresonim trajtimin e tyre me prioritet, te bindur ne vullnetin e drejtuesve te sistemit penitenciar si ne nivel politik edhe ekzekutiv per te adresuar me tej e ne vijimsi edhe nevojat e grupeve te tjera vulnerabile si mund te jete mosha e trete.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe në bazë të Nenit 81/2 pika “b” të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës.

### **REKOMANDOJMË:**

**Marrjen e masave për mbylljen e IEVP Ali Demi dhe sistemimi i të paraburgosurave dhe të dënuarave në një institucion alternativ të vuajtjes së dënimit.**

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

**Avokati i Popullit**

**Erinda Ballanca**